



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 185, Datë 10.11.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LIÇENCIMIN E SHOQËRISË “PRIMA
ENERGY” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5, pika 1 gërma “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “PRIMA ENERGY” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “PRIMA ENERGY” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat (“a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b” “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licensimin e shoqërisë “PRIMA ENERGY” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 - vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari
Petrit AHMETI